



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VI**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës  
Mbledhja nr. 20

Prishtinë, më 22.06. 2018, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Zoran Mojsilović, zëvendëskryetar i dytë, Fatmir Xhelili, Muharrem Nitaj, Aida Dërguti, Fadil Beka dhe Bahrim Shabani, anëtarë.

Munguan: Ramiz Kelmendi, Xhelal Sveçla dhe Ismet Beqiri

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

**Mbledhjen e kryesoi,** Haxhi Shala, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e Komisionit, të mbajtura më 29.3.2018 dhe 30.3.2018;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

4. Diskutim rreth procesit të anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL;
5. Të ndryshme.

*Kryetari i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.*

1. Miratimi i rendit të ditës;

**Kryetari**, kërkoi që të deklarohen deputetët nëse janë për këtë rend dite.

**Fatmir Xhelili**, tha se në lidhje me pikën e rendit të ditës, rreth procesit të anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL”, nuk e konsideron të nevojshme të jetë në këtë rend dite, pasi edhe Qeveria janë angazhuar në këtë proces, kurse edhe Komisioni i ka dhënë përkrahje, dhe e sheh si të panevojshme diskutimin në këtë mbledhje.

*Rendi i ditës u miratua me ndryshime.*

*Komisioni vendosi që pika e , Diskutim rreth procesit të anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL, të hiqet nga rendi i ditës, pasi nuk konsiderohet i nevojshëm diskutimi për këtë çështje dhe nuk ka dokumentacion relevant.*

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e Komisionit të mbajtura më 29.3.2018 dhe 30.3.2018;

*Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.*

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

**Kryetari**, shtoi se Projektligjit nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është proceduar nga Qeveria. Do të planifikohen disa aktivitete gjatë shqyrtimit, kurse edhe disa organizata kanë ofruar mbështetje gjatë shqyrtimit.

**Rexhep Selimi**, në lidhje me projektligjin, theksoi që Komisioni do të jap kontributin gjatë shqyrtimit të tij, dhe e vlerësoi si të nevojshëm që sa më shpejt të kompletohet Bordi i Agjencisë dhe theksoi se e mbështet procedimin për votimin në parim të këtij projektligji.

**Fatmir Xhelili**, theksoi se e mbështet që projektligji të procedohet në seancë për lexim të parë, duke e konsideruar si të nevojshëm këtë projektligj që do të ndihmojë në kompletimin dhe funksionimin e agjencisë.

*Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:*

**VENDIM**

*Miratohet në parim Projektligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit për tu proceduar për shqyrtim të parë, në mbledhje plenare dhe i rekomandon Kuvendit, miratimin e tij në parim.*

**Kryetari**, propozoi që edhe grupi punues për shqyrtimin dhe amendamentimin e këtij projektligji të formohet sot.

*Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:*

**VENDIM**

Formohet Grupi i Punës për shqyrtimin e Projektligjit nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale:

1. Grupi i Punës ka këtë përbërje: Fatmir Xhelili, kryesues, Rexhep Selimi, Zoran Mojsiloviq, Aida Dërguti dhe Bahrim Shabani anëtarë.
2. Secili anëtarë i Komisionit sipas interesimit mund ti bashkëngjitet Grupit të Punës gjatë punës së tij.
3. Grupi i Punës në bashkëpunim me Njësinë Koordinuese të Komisionit, të hartojë planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin më shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.

**4. Të ndryshme.**

**Fatmir Xhelili**, propozoi që të formohet Grupi i Punës për mbikëqyrjen e Ligji të Policisë së Kosovës. Pasi nga puna e grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit të IPK-së kanë dal disa çështje, të cilat do të ishte mirë që të shikohen edhe gjatë procesit për mbikëqyrjen e Ligjit të Policisë së Kosovës.

*Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së në këtë pikë të rendit të ditës, njëzëri nxori këtë:*

**VENDIM**

*Formohet Grupi i Punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës.*

- 1. Grupi i Punës ka këtë përbërje: Haxhi Shala, raportues, Rexhep Selimi, Fadil Beka, Zoran Mojsilović, Muharrem Nitaj dhe Ismet Beqiri, anëtarë.*
- 2. Secili anëtar i Komisionit, sipas interesimit mund ti bashkëngjitet Grupit të Punës gjatë punës së tij.*
- 3. Grupi i Punës në bashkëpunim me Njësinë Koordinuese të Komisionit harton Planin e veprimit dhe pastaj duhet të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i Komisionit.**

**Kryetari i Komisionit,**

---

**Haxhi Shala**